



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Shijak, më 29.06.2026

PROJEKT-VENDIM

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR.46 DATË 22.05.2020 ‘PËR MIRATIMIN E PËRFITUESVE ME NIVEL DËMI DS1, DS2, DS3 RIPARIME’ ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, pikat 3 e 8, 20, 21, pikat 3 e 4 , 22, pika 4, 23 pika 4, 25, pika 2 dhe 34, pika 6, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimit Nr. 886, datë 30.12.2019, “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2019, per Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë , për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve në njësitë e qeverisjes vendore, të prekuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019”, Kryetari i Bashkisë propozoi,

PËR TË VENDOSUR:

- 1.Miratimin e 2 përfituesve të kualifikuar, sipas ankesës së bërë nga aplikantet për vlerësimin e dëmeve në ndërtesa nga tërmeti i datës 26.11.2019, me llojin e dëmit DS3.
- 2.Ngarkohen Fondi Shqiptar i Zhvillimit si njësi zbatuese dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në Bashkinë Shijak, për zbatimin e këtij vendimi.

Juriste
Albiona Mehmeti

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Kozeta Doda

Drejtorja e Planifikimit dhe
Zhvillimit të Territorit
Jonida Goga

KRYETARI

Eltor Arbana

Adresa: Lagja "Erzen" Shijak, Tel: +35557122152, website: www.shijak.gov.al, e-mail: info@shijak.gov.al